



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4257/prot.

B.Curri, më 29.09.2025

VENDIM

Nr 59 Date 25.09.2025

“PER SHPALLJEN QYTETAR NDERI”

Në përmbushje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 germa “m”, Ligjit Nr 94/2022 “Për titujt e Nderit dhe titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 25.09.2025

V E N D O S I :

1. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” z.**Avni Breçani** (pas vdekjes) *me këtë motivacion:* “Për kontributin e dhënë në institucionet shtetërore si në fushën e arsimit, sigurimeve shoqërore si specialist dhe jurist i përkushtuar”.
2. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” z. **Dede Prenga** *me këtë motivacion :* “Personalitet me kontribut të veçantë për komunitetin tonë duke u bërë bashkiniciator në fillimin e hapjes së Unazës së bjeshkeve në krye të forcave të xhenjos të Forcave të Armatosura”.
3. T’i japë titullin “Qytetar Nderi z. **Hysen Papa**(pas vdekjes) *me këtë motivacion :* “Në vitet 1970-1978, si drejtues kryesor i rrethit, një personalitet me vizion dhe i përkushtuar në shërbim të komunitetit, ka ndërtuar dhe transformuar rrënjësisht qytetin e Bajram Currit dhe ka kontribuar në zhvillimin e arsimit, të kulturës dhe frutikulturës”.
4. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” z. **Feriz Teshnjeva**, *me këtë motivacion :* “ Për kontributin e jashtëzakonshëm e dhënë në luftën për Çlirimin e Kosovës”.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Ergent GJONGECAJ



KRYETAR
Arbër ÇAKRAJ